

Mosdhënie e pagesës kalimtare

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, ka paraqitur ankesë shtetasi A.T, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosdhënien në kohë të shpërblimit të menjëhershëm për vjetërsi në punë si dhe mosdhënien e pagesës kalimtare në muajin Tetor 2020.

Sipas shpjegimeve të tij, ka punuar në një nga Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në jug të vendit dhe në muajin Korrik 2020 ka kërkuar që të largohet nga Policia e Burgjeve për arsye shëndetësore. Në zbatim akteve nënligjore, shtetasi A.T do trajtohej me shpërblim të menjëhershëm dhe pagesë kalimtare për 24 muaj, bazuar në ligjin nr. 10142 datë 15.05.2009 *“Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.

Pretendimi i tij qëndronte në faktin se, shpërblimin e menjëhershëm për vjetërsi në punë në masën e dy pagave referuese mujore e ka përfituar 1 muaj e 15 ditë pas largimit nga detyra, ndërsa pagesën kalimtare e ka përfituar në muajin Nëntor 2020 dhe jo në muajin Tetor 2020, në kundërshtim me dispozitat e ligjit të sipërcituar, në të cilin është parashikuar se pagesa kalimtare duhet të fillojë në muajin e tretë nga data e nxjerrjes në rezervë apo lirim.

Duke e konsideruar këtë çështje, si shkëlqje të të drejtave të tij ligjore, ka kërkuar ndihmën e institucionit tonë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Me marrjen në shqyrtim të ankesës,

Duke iu referuar ligjit nr. 10142 datë 15.05.2009, në dispozitat e tij, neni 12 dhe 14 janë parashikuar edhe afatet kohore të përfitimit të shpërblimit të menjëhershëm dhe pagesës kalimtare si dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

Sipas legjisllacionit në fuqi, në kushtet e shtetasit A.T, përfundimi i përfitimit të pagesës kalimtare, përcakton të drejtën e tij për fillimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

Mosdhënia e pagesës kalimtare për periudhën 23.09.2020-22.10.2020, përpos mospërfitimit financiar, penalizon ankuesin për datën e fillimit të pensionit të parakohshëm në shërbim.

Pavarësisht verifikimeve të bëra për qënien në punë ose jo të shtetasit A.T, në çdo kohë të përfundimit të verifikimit përkatës, pagesa kalimtare duhet të fillonte nga data e lindjes të së drejtës për përfitim.

Nga përgjigja e ardhur nga ai institucion, rezultoi se muaji i tretë nga data e nxjerrjes në lirim nënkupton periudhën 23.09.2020 deri në datën 22.10.2020. Por ankuesit i është mohuar pagesa kalimtare për ta përfituar më datë 1 Tetor për periudhën 23.09.2020-22.10.2020, pasi ajo pagesë ka filluar më datë 1 Nëntor 2020.

Nga data e fillimit të përfitimit të pagesës kalimtare deri në përfundim të këtij përfitimi financiar, datë 22 Korrik 2022, ankuesi përfiton vetëm 21 paga dhe jo 22 paga, sipas përcaktimit ligjor.

Me qëllim përfitimin e të drejtave të tij ligjore, rekomanduam dhënien e pagesës kalimtare për periudhën 23.09.2020 - 22.10.2020 shtetasit A.T.

Nga përgjigja e ardhur dhe komunikimi me ankuesin, rezultoi se rekomandimi ynë është marrë në konsideratë dhe shtetasi A.T përfitoi pagesën për periudhën 23.09.2020-22.10.2020.